



## **VENDIM MBI PAPRANUESHMËRI**

**Data e miratimit: 28 qershor 2016**

**Numri i lëndës: 2016-03**

**Afrim Islami**

**kundër**

**EULEX-it**

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 28 qershor 2016, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese  
Z. Guénaél METTRAUX, anëtar  
Znj. Elka FILCHEVA – ERMENKOVA, anëtare zëvendësuese

Ndihmuar nga  
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor  
Z. Paul LANDERS, zyrtar ligjor  
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi më 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

### **I. PROCEDURAT PRANË PANELIT**

1. Ankesa është regjistruar më 8 shkurt 2016. Për shkak të dorëheqjes së znj. Katja Dominik si anëtare e Panelit, ajo u zëvendësua në

përbërjen e Panelit nga znj. Elka Filcheva-Ermenkova, anëtare zëvendësuese e Panelit, në përputhje me Rregullin 14 par. 2 të Rregullores së Punës.

## II. FAKTET

2. Faktet e lëndës, siç janë paraqitur nga ankuesi, mund të përmbliidhen si në vijim.
3. Më 27 gusht 2015, kur ankuesi kishte shkuar për të hapur zyrën e tij "autoshköllën Abis" në rr. Agim Ramadani, nr.22/44, ai ishte konfrontuar nga zyrtarë të sigurimit të Ndërmarrjes Publike Banesore dhe ishte penguar të hynte në zyrën e tij.
4. Ankuesi menjëherë kishte shkuar në Zyrat e Ndërmarrjes Publike Banesore, në mënyrë që të gjej pse ishte penguar të hynte në zyrën e tij. Drejtori i Ndërmarrjes Publike Banesore, N.K., e ka informuar atë se ai duhej të bënte pagesën e një borxhi prej 37.000 eurosh dhe të bënte parapagimin e qirasë për tre vjet. Ankuesi e bëri pagesën e borxhit të papaguar. Pas kësaj, ankuesi telefonoi dhe më pas shkoi në stacionin e policisë Qendër në Prishtinë. Supozohet se iu tha që ai mund të dëbohej nga zyra e tij.
5. Kur ankuesi u kthye në zyrën e tij, pesëmbëdhjetë zyrtarë të sigurimit të një kompanie private të dërguar nga Ndërmarrja Publike Banesore hynë menjëherë në zyrën e tij pas tij. Pas intervenimit të një zyrtari të policisë, pjesëtarët e sigurimit u tërhoqën. Ankuesi përsëri ishte në kontakt me policinë vendore në lidhje me këtë çështje. Dy orë më vonë, dy zyrtarë të policisë erdhën në zyrën e ankuesit dhe e kanë mbajtur ankuesin dhe djalin e tij në stacionin policor deri në mëngjes. Më pas ankuesi dhe djali i tij u dërguan te një prokuror i Kosovës, S.I., i cili kërkoi falje për mbajtjen e tyre dhe supozohet se ka deklaruar që Policia i kishte keqkuptuar udhëzimet e tij.
6. Në mbrëmjen e asaj dite, avokati i ankuesit ka kërkuar nga Policia të marrë arsyen e mbajtjes së tij në paraburgim. Ai nuk ka marrë asnjë shpjegim me shkrim, por ju tha se mbajtja e tij ishte urdhëruar nga prokurori. Të nesërmen ai kërkoi nga prokurori të ofroj një shpjegim zyrtar për mbajtjen e tij.
7. Në mëngjesin e 2 shtatorit 2015, ankuesi kishte shkuar në punë. Edhe një herë ai gjeti persona që kishte hyrë brenda. Ata u larguan kur erdhi policia. Më pas ai kishte kontaktuar edhe me policinë e Kosovës dhe me prokurorinë e Kosovës në lidhje me këtë çështje.
8. Ankuesi thekson se tri apo më shumë javë më vonë, ankuesi ka pasur kontakte me drejtorin e Ndërmarrjes Publike Banesore, me të cilin ka biseduar për zgjidhjen e kësaj çështjeje. Kjo në anën tjetër ka rezultuar në kontakte të tjera me policinë dhe prokurorët e Kosovës.

9. Më pas kanë nisur procedurat ligjore nga Ndërmarrja Publike Banesore kundër ankuesit përmes aktakuzave të mëposhtme: Aktakuza C.nr.771/08 për pagesën e borxhit dhe aktakuza C.nr. 576/14 për lirimin e zyrës dhe për pagesën e borxhit. Ndërmarrja Publike Banesore më pas i ka tërhequr këto dy aktakuza: Përmendet Aktvendimi i Gjykatës Themelore të Prishtinës, C.nr.771/08 i datës 24.11.2015 dhe Aktvendimi C.nr.576/14 i datës 30.11.2015.
10. Ankuesi ka raportuar rastin në Inspektoratin Policor të Kosovës, IPK/DSHMA/770/215 me 30 shtator 2015. F.F. nga Drejtoria e Standardeve Profesionale ka thirrur ankuesin dhe e ka marrë në pyetje atë, mirëpo atij nuk iu ishte dhënë ndonjë numër i rastit. Ankuesi nuk ka marrë ndonjë informacion pasues nga Drejtoria e Standardeve Profesionale.

### **III. ANKESAT**

11. Pa përmendur ndonjë dispozitë të veçantë të instrumenteve ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, mund të thuhet nga përmbajtja e ankesës që ankuesi pretendon se ishte arrestuar padrejtësisht nga policia (Neni 5 i KEDNj-së), se e drejta e tij në jetën private ishte shkelur (neni 8 i KEDNj-së), se i ishte mohuar e drejta e tij për zgjidhje efektive (neni 13 i KEDNj-së) dhe se ishte prekur e drejta e tij për gëzim paqësor të pronës së tij (neni 1, Protokollin 1 i KEDNj-së).

### **IV. LIGJI**

12. Si çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar për të përdorur instrumentet e të drejtave të njeriut siç pasqyrohen në konceptin llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa) dhe Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që duhet të garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet ligjore demokratike.
13. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do ta pranojë ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullën 29 të rregullores së vet të punës.
14. Sipas rregullës 25, paragrafit 1 të rregullores së vet të punës, Paneli mund të shqyrtoj ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-it në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv në fushën e drejtësisë, policisë dhe doganave.

15. Në rastin konkret, Paneli konstaton se nuk është argumentuar e leje më treguar se EULEX-i ishte i përfshirë në ndonjë mënyrë në shkeljet e supozuara të të drejtave të ankuesit. Ankuesi nuk duket se ka kërkuar ndihmën ose përfshirjen e ndonjë njësie përkatëse të EULEX-it, e poashtu nuk e sugjeron as për fajësinë nga ana e tij sa i përket dështimit për mosveprim.
16. Ndërsa Paneli pranon se çështjet e ngritura nga ankuesi (në veçanti paraburgimin e ankuesit; dështimin e autoriteteve për të vepruar me vendosmëri dhe në mënyrë efektive për të ndaluar ngacmimin e mëtejme të ankuesit; dështimin për të hetuar marrjen e një sasi të madhe parash prej tij) janë të një natyre serioze dhe shkaktojnë shqetësime, ato nuk hyjnë në kuadër të mandatit ekzekutiv të EULEX-it. Si pasojë, ato bien jashtë kompetencave të Panelit, siç saktësohet në rregullën 25 të rregullores së vet të punës dhe OPLAN-it të EULEX-it (*shih Shaip Gashi kundër EULEX-it, 2013-20, 26 nëntor 2013 § 9; Jovanka, Dragan dhe Milan Vukovic kundër EULEX-it, nr. 2013-18, 7 prill 2014, §§ 11-12*).

#### **PËR KËTO ARSYE,**

Paneli njëzëri konstaton se nuk ka kompetencë për ta shqyrtuar këtë ankesë, pasi ajo bie jashtë kompetencave të tij në bazë të nenit 29 (d) të rregullores së vet të punës, dhe

#### **SHPLL ANKESËN TË PAPANUESHME.**

Për Panelin,

John J. RYAN  
Zyrtar i lartë ligjor



Magda MIERZEWSKA  
Kryesuese